

RREGULLORE E PROMOCIONIT "SAMSUNG GALAXY WATCH3"

Përpara blerjes së pajisjes Samsung Galaxy Watch3, ju lutem lexoni rregulloren e promovionit "Samsung Galaxy Watch3" (në vijim "Rregullorja").

1. Organizatori i promovionit

Samsung Electronics Austria GmbH, me seli në Vjenë, në adresën Praterstrasse 31/14 Obergeschoss, Vjenë, Austri dhe me numër regjistrimi FN 217924b (në vijim "Samsung") organizon promovionin e pajisjes Samsung Galaxy Watch3.

2. Kohëzgjatja e promovionit, përdoruesi dhe dhurata

Promovioni i pajisjes Samsung Galaxy Watch3 është i disponueshëm për përdoruesit në Republikën e Shqipërisë në periudhën nga data 7 Gushti deri më 20 Gusht 2020 ose për periudhë më të shkurtër nëse përpara datës së mbarimit të promovionit përfundon stoku i baterisë së jashtme wireless (kodi i modelit: EB-U3300XJEGEU).

Termi "përdorues" do të thotë të gjithë personat fizik dhe juridik me banim/seli në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilët blejnë pajisjen për nevojat e tyre dhe jo për ta rishitur.

Përdoruesit të cilët, gjatë periudhës së promovionit, blejnë Samsung Galaxy Watch3 nga shitësit e autorizuar të Samsung të listuar në paragrafin 4 të kësaj Rregulloreje, do të marrin si dhuratë baterinë e jashtme wireless EB-U3300XJEGEU (në vijim "Dhurata").

3. Marrja/Dorëzimi i dhuratës

Përdoruesit të cilët blejnë Samsung Galaxy Watch3 në pikën e shitjes së shitësit të autorizuar të Samsung, do të marrin Samsung Galaxy Watch3 dhe Dhuratën menjëherë pas blerjes.

Përdoruesit të cilët blejnë Samsung Galaxy Watch3 nëpërmjet dyqanit online të shitësit të autorizuar të Samsung bien dakord tërësisht me shitësin e autorizuar lidhur me dorëzimin të Samsung e Samsung Galaxy Watch3 dhe Dhuratës.

Çmimi i shitjes i Samsung Galaxy Watch3 (pavarësisht mënyrës së blerjes), i përket vendimit tregtar të secilit shitës të autorizuar të Samsung.

4. Shitësit e autorizuar të Samsung

Blerja e Samsung Galaxy Watch3 është e mundshme vetëm pranë shitësve të mëposhtëm të autorizuar të Samsung:

- Neptun Albania
- Globe Shops
- Vodafone Albania
- Telekom Albania

5. Të dhënat personale të përdoruesit

Për qëllime të këtij Promovioni, Samsung nuk mbledh apo përpunon asnjë të dhënë personale të përdoruesit.

6. E drejta për të ndryshuar kushtet e promovimit

Samsung rezervon të drejtën që, në çdo moment, për shkaqe të justifikuara, të ndryshojë këtë Rregullore me detyrimin për ta publikuar pa vonesë.

Kjo Rregullore publikohet më 7 Gusht 2020, në faqen www.samsung.com/al/offer/gw3-sos-promo/ datë nga e cila hyn në fuqi.